


REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA TIRANE
Noter: Robert KOLI
Studio: Rr. "Urani Pano" Pa. 11 katesh
Nr. 17816 Rep.
Nr. 3591 Kol.



KONTRATE SHITJE AKSIONESH

Ne Tirane, sot me date 27/10/2006(dymije e gjashte), para meje noter Robert KOLI, me seli si me siper, u paraqiten personalisht:

Z. SHYQYRI DURAKU, i biri i Alushit, lindur ne Kukes me 08/12/1954 dhe banim ne Tirane, Rr. Kavajes, Nr. 58, mbajtes i passaportes me nr. 06087763, ketu me poshte referuar si **Shitesi**;

Dhe

Z. AVNI PONARI, i biri i Rexhepit, lindur ne Tropoje me 28/07/1957 dhe banim ne Tirane, Bul Marsel Kashen, Pall. 1, Ap.12, ketu me boshte referuar si **Bleresi**.

Te cilet me kerkuan redaktimin e kesaj kontrate si vijon:


MEQENESE

Shitesi, Shyqyri Duraku, eshte aksioner ne shoqerite e sigurimeve:

1. "SIGAL" sh.a. person juridik shqiptar krijuar si i tille me Vendim te Gjykates se Rrethit Tirane Nr. 20863, date 22.02.1999, me adrese ne Tirane, Bulevardi "Zog I", Nr.1, me dege ne Kosove dhe kompani bije ne Maqedoni. Ne kete shoqeri shitesi Shyqyri Duraku zoteron 32 000(tridhjetete e dy mije) aksione (26.40%), pronesia mbi te cilat vertetohet me Vendim Gjykate te Rrethit Tirane Nr.20863/12 date 27/10/2006 dhe Ekstrakt i Rregjistrimit te Aksioneve leshuar nga Qendra e Rregjistrimit te Aksioneve sh.a. Tirane;
2. "SIGAL LIFE" sh.a. person juridik shqiptar krijuar si i tille me Vendim te Gjykates se Rrethit Tirane Nr. 32018, date 03.09.2004, me adrese ne Tirane, Bulevardi "Zog I", Pall. Diplomateve Nr.57. Ne kete shoqeri shitesi Shyqyri Duraku zoteron 33 000(tridhjetete e tre mije) aksione (26.40%), pronesia mbi te cilat vertetohet me Vendim Gjykate te Rrethit Tirane Nr.32018/2 date 22/06/2006 dhe Ekstrakt i Rregjistrimit te Aksioneve leshuar nga Qendra e Rregjistrimit te Aksioneve sh.a. Tirane;

Shitesi, Shyqyri Duraku, ka vendosur te shes pjese te aksioneve qe ai zoteron ne te dyja shoqerite "SIGAL" sh.a.(me efekt ne degen ne Kosove dhe kompanine bije ne Maqedoni) dhe "SIGAL LIFE" sh.a

Bleresi, Avni Ponari eshte aksioner ne shoqerite e sigurimeve:

- 
1. "SIGAL" sh.a. person juridik shqiptar krijuar si i tille me Vendim te Gjykates se Rrethit Tirane Nr. 20863, date 22.02.1999, me adrese ne Tirane, Bulevardi "Zog I", Nr.1, me dege ne Kosove dhe kompani bije ne Maqedoni. Ne kete shoqeri bleresi Avni Ponari zoteron 35 200 aksione (29.04%), pronesia mbi te cilat vertetohet me Vendim Gjykate te Rrethit Tirane Nr.20863/12 date 27/10/2006 dhe Ekstrakt i Rregjistrimit te Aksioneve leshuar nga Qendra e Rregjistrimit te Aksioneve sh.a. Tirane;
 2. "SIGAL LIFE" sh.a. person juridik shqiptar krijuar si i tille me Vendim te Gjykates se Rrethit Tirane Nr. 32018, date 03.09.2004, me adrese ne Tirane, Bulevardi "Zog I", Pall. Diplomateve Nr.57. Ne kete shoqeri bleresi Avni Ponari zoteron 36 300(tridhjetë e gjashtë mijë e treqind) aksione (29.04%), pronesia mbi te cilat vertetohet me Vendim Gjykate te Rrethit Tirane Nr.32018/2 date 22/06/2006 dhe Ekstrakt i Rregjistrimit te Aksioneve leshuar nga Qendra e Rregjistrimit te Aksioneve sh.a. Tirane;

Bleresi, Avni Ponari deshiron dhe eshte dakort te blej pjese te aksioneve te zoteruar nga Shitesi Shyqyri Duraku ne te dyja shoqerite "SIGAL" sh.a.(me efekt ne degen ne Kosove dhe kompani bije ne Maqedoni) dhe "SIGAL LIFE" sh.a. nepermjet nenshkrimimit dhe shlyerjes, sipas kushteve dhe afateve te kesaj Kontrate.

ATEHERE Palet bien dakort si vijon:

Neni 1 – Objekti i Kontrates

Objekti i kesaj Kontrate eshte shitja e:

1. 19 878(netembehjete mijë e teteqind e shtatdhjete e tete) aksioneve – (16.40%) qe Shitesi zoteron ne shoqerine "SIGAL" sh.a. nga Z. Shyqyri Duraku tek Z.Avni Ponari;
2. 20 500(njzet mijë e peseqind) aksioneve – (16.40%) qe Shitesi zoteron ne shoqerine "SIGAL LIFE" sh.a. nga Z. Shyqyri Duraku tek Z.Avni Ponari;

Neni 2- Cmimi i shitjes

Palet e kesaj kontrate kane rene dakort qe numri i aksioneve te percaktuara ne Objektivin e kesaj kontrate, referuar te dyja shoqerive "SIGAL" sh.a. dhe "SIGAL LIFE" sh.a. do te shitet per nje cmim total prej 3.3milion Euro.

Neni 3- Menyra e shlyerjes se Cmimit te Aksioneve

Palet bien dakort qe pagesa e cmimit te aksioneve te behet ne 3(tre)kete.

Kesti i pare prej 1 000 000(nje milion) Euro do te paguhet brenda dates 15 Nentor 2006.

Kesti i dyte prej 1 500 000(nje milion e peseqind mijë)Euro do te paguhet brenda dates 30 Nentor 2006.Kesti i trete prej 800 000(teteqind mijë)Euro do te paguhet brenda dates 30 Dhjetor2006.



Neni 4- Perqindjet aksionere pas nenshkrimit te kesaj Kontrate

4.1 Pas nenshkrimit te kesaj Kontrate dhe kryerjes se pageses se rene dakort si ne Nenin 3 me larte gjendja e aksioneve ne shoqerite "SIGAL" sh.a. dhe "SIGAL LIFE" sh.a. te Z. Shyqyri Duraku paraqitet si vijon:

"SIGAL" sh.a. - 12 122(dymbedhete mije e njeqind e njezet e dy) aksione (10.00%)
"SIGAL LIFE" sh.a. - 12 500(dymbedhete mije e peseqind) aksione (10.00%)

4.2 Pas nenshkrimit te kesaj Kontrate dhe kryerjes se pageses se rene dakort si ne Nenin 3 me larte gjendja e aksioneve ne shoqerite "SIGAL" sh.a. dhe "SIGAL LIFE" sh.a. te Z. Avni Ponari paraqitet si vijon:

"SIGAL" sh.a. - 55 078(pesedhete e pese mije e shtatedhete e tete) aksione (45.44%)
"SIGAL LIFE" sh.a. - 56 800(pesedhete e gjashte mije eteteqind)aksione(45.44%)

Neni 5- Transferimi i pronesise mbi aksionet

Me nenshkrimin e kesaj Kontrate referuar pikes 4.1 dhe 4.2 Shitesi Shyqyri Duraku heq dore nga pronesia mbi aksionet e cituara me larte dhe pronar i vetem e i ligjshem, me te drejta dhe detyrime te plota mbi aksionet objekt shitje i kesaj Kontrate, behet Bleresi Avni Ponari.


Neni 6- Te ndryshme

1. Kjo Kontrate ka fuqi ligjore per palet dhe pasuesit e tyre.
2. Kjo Kontrate, te drejta dhe detyrime e paleve do te rregullohen, interpretohen dhe zbatohen ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi. Ne rast mosmarrveshje kompetente per zgjidhjen e tyre do te jete Gjykata e Rrethit Tirane.
3. Statutet e shoqerive "SIGAL" sh.a. dhe "SIGAL LIFE" sh.a. nuk parashikojne qe te jepet pelqimi i shoqerise per transferim pronesie mbi aksionet kur transferim kryhet ndermjet dy aksionereve aktual te shoqerise. Pavaresisht ketij fakti kjo shitje, per sa i perket aksionerit AAEF gezon pelqimin me shkrim konform mardhenieve kontraktore midis aksionereve te shoqerive objekt i kesaj Kontrate.
4. Per cdo gje jo te parashikuar shprehimisht ne kete Kontrate do te zbatohen dispozitat ligjore te legjislacionit shqiptar ne fuqi.


Kjo Kontrate u perpilua nga une noteri ne 4(kater) origjinale me te njejten vlere, dhe pasi lexohet nga palet e gjendet konform vullnetit tyre te lire e te plote nenshkruhet rregullisht.

SHITESI

SHYQYRI DURAKU

Shyqyri Duraku


NOTER
Robert KOLI



BLERESI

AVNI PONARI

